

VENDIM
Nr.1204, datë 27.8.2008

**PËR MIRATIMIN E GARANCISË QEVERTARE, TË LËSHUAR NË FAVOR TË
RAIFFEISEN BANK SHA ALBANIA, NË KUADËR TË KONTRATËS SË HUASË,
NDËRMJET KËSAJ BANKE DHE KESH SHA-SË, PËR SHUMËN EKUIVALENTE, NË
LEKË, TË SHUMËS 40 (DYZET) MILIONË EURO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 16 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Financave dhe të Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të Raiffeisen Bank sh.a., Albania, në kuadër të kontratës së huasë, ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a.-së, për shumë ekuivalente, në lekë, të shumës 40 (dyzet) milionë euro.

2. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha